

Nr. Prot. 046/B/17

VENDIM Nr.1029

Për
Fillimin e Procesit të Konsultimit Publik
për
ndryshimin e
“Rregullores nr. 20 për Kualitetin e Shërbimeve të Komunikimeve Elektronike”

Në mbështetje të nenit 1, nenit 10, paragrafi 4), neni 69 paragrafi 1) dhe 2), neni 79, paragrafi 1) dhe 2) dhe nenit 82 i Ligjit Nr. 04/L-109 për Komunikime Elektronike (*tutje referuar si - Ligji*) dhe nenit 20 të Rregullores së Brendshme (*Ref. Nr.Prot.161/06*) të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (*tutje referuar si - Autoriteti*), Bordi i Autoritetit i përbërë nga,

- 1) z. Kreshnik Gashi Kryetar i Bordit
- 2) z. Nijazi Ademja Anëtar i Bordit
- 3) z. Hazir Hajdari Anëtar i Bordit
- 4) z. Bahri Anadolli Anëtar i Bordit

në mbledhjen e 19-të me radhë të mbajtur më datë 27 qershor 2017, pas shqyrtimit të materialit të përgatitur nga DKE dhe DL, unanimisht morri këtë:

V E N D I M

- I. Miratohet fillimi i Konsultimit Publik për ndryshimin e “**Rregullores nr. 20 për Kualitetin e Shërbimeve të Komunikimeve Elektronike**”.
- II. Procesi i konsultimit publik fillon më datë **07 Korrik 2017** dhe përfundon më datë **21 Gusht 2017**.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

A R S Y E T I M

Ligji, respektivisht neni 10, paragrafët 4) përcakton se Autoriteti: “*Miraton legjislacionin sekondar lidhur me këtë ligj, të cilat janë në kompetencë të Autoritetit, mbështetur në dispozitat e këtij ligji.*”

Neni 82 i Ligjit përkufizon se Autoriteti gjatë aprovimit të akteve normative duhet t'i publikojë ato në pajtim me kushtet dhe procedurat e vendosura nga Autoriteti, duke ua ofruar mundësinë personave të interesuar që në afat të arsyeshëm kohor të shprehin pikëpamjet e tyre.

Neni 69 i Ligjit përcakton se *“Ndërmarrësit e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike publike janë të detyruar ta publikojnë informacionin e duhur, të krahasueshëm dhe të përditësuar për cilësinë e shërbimeve të ofruara prej tyre.”*

Duke pas parasyshë atë që u tha më lartë si dhe me qëllim të implementimit të Rregullores (EU) 2015/2120 të Parlamentit Evropian për Internetin e Hapur është vendosur sikurse në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshilla Juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit.

Prishtinë, 07/07/2017

Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare

**Kreshnik Gashi
Kryetar i Bordit**

Aktvendimi i dërgohet:

- Ofruesve të shërbimeve të komunikimeve elektronike mobile;
- Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik/Departamenti i Postë Telekomunikacionit dhe Teknologjisë Informative;
- Departamentit të Komunikimeve Elektronike, ARKEP;
- Arkivit, ARKEP